



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2983 prot.

Fushë-Arrëz, më 25.09.2025

PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 25.09.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

Këshilltarët: **Bardhok Qafa; Besjana Marku; Franc Doda; Lezina Ceca; Lin Prendi; Mustaf Pashkaj; Tereze Dema; Valentina Lleshaj; Vjollca Tabakaj; Zef Cara.**

(10 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë Kryetari i Bashkisë, **Z. Hil Curri.**

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas agjendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Zëvendëskryetari i Këshillit Bashkiak, **z. Bardhok Qafa:** Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Shtator 2025! Në vijim të njoftimit të fundit datë, 17.09.2025, zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen (**10 Këshilltarë**) e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak, datë 25.09.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.08.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Gusht 2025.
4. Projektvendim për miratimin e Fazës së dytë të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028".
5. Raport i Monitorimit të Buxhetit për periudhën Maj - Gusht 2025.
6. Kalendari i konsultimit publik për PBA 2026-2028 dhe Paketën Fiskale 2026.
7. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
8. Të ndryshme.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 25.09.2025.

Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës sipas Njoftimit:

- Miratohet rendi i ditës me,

10 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.08.2025.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak:

Procesverbali mban gjithçka lidhur me mbledhjen e muajit Gusht 2025. Këshilltarët e kanë në dosjet e tyre secili, gjithashtu procesverbali është hedhur në web-in zyrtar të Bashkisë (<https://bashkiafushearrez.gov.al/>) menjëherë mbasi është zbardhur. Nëse ka diçka ndokush për të thënë, mundet.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.08.2025.

- Miratohet Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 25.09.2025:

9 vota pro

0 vota kundër

1 votë abstenim

Pika numër 3 e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Gusht 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Klotilda Curri, Përgjegjëse e Zyrës së Çështjeve Sociale:

Në Bashkinë Fushë-Arrëz, trajtohen me Ndhimë Ekonomike, mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike në masen 6%, familje të cilat janë të varfëra ku bazohemi edhe te VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kritereve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”. Qëllimi i trajtimit të këtyre familjeve me bllok-ndihmë 6% , është të ofrohet ndihmë për grupet në nevojë , të cilët nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, si dhe zbutje të varfërisë.

Për muajin Gusht 2025 kemi propozuar për ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës prej 6%, 27 familje, me fond 106,734 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,778,916 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën 106,458 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz, 13 familje me fond 41,732 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali, 4 familje me fond 13,999 lekë.
3. Njësia Blerim, 3 familje me fond 14,313 lekë.

4. Njësia Fierzë, 3 familje me fond 19,424 lekë.

5. Njësia Iballë, 4 familje me fond 16,990 lekë.

Klotilda Curri, Përgjegjëse në Sektorin e Çeshtjeve Sociale, shpjegon se nuk shtohet dhe as nuk hiqet në bllok-ndihmën e 6% asnjë familje për këtë muaj. Znj. Curri gjithashtu tregon se trajtohen me ndihmën ekonomike prej 6% të gjitha familjet që dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme: Hajrullah Ademi, Esat Cufaj, File Lleshi, Musli Hamza, Ndoc Prendi.

Franc Doda, anëtar i komisionit, i njohur edhe më parë me materialin, shprehet se është dakord me listën emrore të përfituesve të Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Gusht 2025 të paraqitur nga Sektori i Çeshtjeve Sociale ku rezulton të mos ketë as të shtuar dhe as të larguar krahasuar me listen e muajit Korrik.

Gjithashtu do të kemi në vëmendje që të përfitojnë personat që plotësojnë kriteret e paracaktuara me vendim të Këshillit Bashkiak. Duhet të ndihmohen persona të tjerë që janë në nevojë dhe plotësojnë kriteret.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Gusht 2025 përmes votimit:

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve lista e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Gusht 2025 me:

10 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 4 e rendit të ditës: Projektvendim për miratimin e Fazës së dytë të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028.

Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Përshëndetje të gjithëve! Projekti i Fazës së Dytë të PBA-së 2026-2028 nuk ka ndryshime nga Faza e Parë e cila është miratuar në Qershor nga Këshilli Bashkiak. Kjo procedurë që po bëjmë tani është detyrim ligjor sipas ligjit me numër 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” që t’i paraqitet Këshillit brenda afateve të përcaktuara.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse nuk ka diskutime ftoj këshilltarët të miratojmë me votë projektvendim për miratimin e Fazës së dytë të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028:

- Miratohet me vota të plota të anëtarëve pjesëmarrës projektvendimi për Fazën e dytë të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028:

10 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 5 e rendit të ditës: Raport i Monitorimit të Buxhetit për periudhën Maj - Gusht 2025.

Raport i Monitorimit të Buxhetit është për periudhën 4-mujor Maj - Gusht 2025 dhe progresivi 8-muaj. Ky Raport është detyrim ligjor që t'i përcillet Ministrisë së Financave dhe të paraqitet në Këshill për njohje brenda muajit të nëntë për 8-muajt e mëparshëm. Për këtë Raport nuk ka vendimmarrje. KB njihet me Raportin e shpenzimeve dhe të ardhurave që Bashkia ka patur për periudhën respective.

Ky Raport siç e keni parë edhe në dosjet tuaja është edhe më i detajuar se e kërkon ligji, është pasqyruar çdo program buxhetor, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzime operative të detajuara. Të gjitha këto janë pasqyruar me përqindje edhe në formë tabelare.

E njëjta procedurë është ndjekur edhe për të ardhurat, sa është niveli i të ardhura, sa është niveli i të ardhura të miratuara, sa është niveli i realizuar për 3-mujorin. Njëjtë edhe këto janë pasqyruar zë për zë edhe në përqindje në formë tabelare.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 5 e rendit të ditës: Kalendar i konsultimit publik për PBA 2026-2028 dhe Paketën Fiskale 2026.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak:

Përshëndetje, mirë se keni ardhë!

Njoftimin për konsultim me publikun mbi draftin e projektplanit Buxhetor Afatmesëm

2026-2028, buxhetin e bashkisë për vitin 2026 si dhe Paketën Fiskale 2026 e keni të gjithë në dosjet tuaja dhe përveçse në dosje Njoftimin e gjeni edhe në faqën web të Bashkisë

<https://bashkiafushearrez.gov.al/>

Ky njoftim i paraqitet Këshillit për njohje të detajeve sepse miratimi është bërë me Vendimin Nr. 63, date 23.12.2024 “ Për miratimin e Planeve të aktivitetit të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025”.

Bazuar në ligjet përkatëse, Bashkia Fushë-Arrëz bën publik :

- Draftin mbi Projektin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028 dhe Buxhetin e bashkisë për vitin 2026;
- Kalendarin e Konsultimit publik mbi PBA 2026-2028.

Ftojme të gjithë qytetarët e bashkisë të japin opinionin dhe rekomandime të tyre:

- Direkt nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takimet publike;
- me shkresë përmes postës në adresë të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz;
- Me email në adresat: info@bashkiafushearrez.gov.al dhe nazeselimaj@yahoo.com deri , më 20.11.2025.

Lutemi qytetarëve të njihen me PBA 2026-2028 në regjistrin elektronik të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për konsultimet me publikun në faqen web të Bashkisë:

<https://bashkiafushearrez.gov.al/>

Aktorët pjesëmarrës në dëgjesa publike do të jenë:

Nga organizatorët: Kryetari i Bashkisë, Zëvendëskryetarët e Bashkisë, Kryetari i KB, Sekretar i KB, Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, anëtarët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të KB, Këshilltarë, Drejtues/punonjës të administratës që lidhen me çështjet që konsultohen.

Nga të ftuarit: Banorët e bashkisë sipas Njësive Administrative, përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues të biznesit medias, kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit komunitarë, grupet e interesit.

Qëllimi: Të mbledhen sugjerimet dhe propozimet e komunitetit lidhur me:

1. Mënyrën se si do të përdoren fondet për ofrimin e shërbimeve nga Bashkia.
2. Shërbimet prioritare të komunitetit.
3. Investimet.
4. Të ardhurat e bashkisë për vitin 2026.

Sqarime për projektaktin:

Publiku do të informohet mbi të dhënat e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetin e bashkisë për vitin 2026, për secilin program buxhetor dhe Paketën Fiskale për vitin 2026.

Gjatë takimeve do të jepet informacion mbi investimet dhe shërbimet kryesore, taksat dhe tarifatat dhe mbi procesin që do të ndiqet për trajtimin e rekomandimeve që dalin nga konsultimi deri në përfshirjen e tyre në buxhet sipas mundësive financiare të bashkisë.

Nr.	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Konsultim publik me banorë të Njësive Administrative Fierzë	23.10.2025	Njësia Administrative Fierzë	10:00	Takim Publik	Bisedë
2	Konsultim publik me banorë të Njësive Administrative Blerim	23.10.2025	Njësia Administrative Blerim	13:00	Takim Publik	Bisedë
3	Konsultim publik me banorë të Njësive Administrative Iballe	5.11.2025	Njësia Administrative Iballe	11:00	Takim Publik	Bisedë
4	Konsultim publik me banorë të Njësive Administrative Qafë-Mali	10.11.2025	Njësia Administrative Qafë-Mali	11:00	Takim Publik	Bisedë
5	Konsultim publik me banorë të Njësive Qendër, Fushë-Arrëz	14.11.2025	Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz	10:00	Takim Publik	Bisedë
6	Konsultim publik Me përfaqësues të Biznesit	14.11.2025	Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz	13:00	Takim Publik	Bisedë

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 7 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Franc Doda, anëtar i KB:

Shqetësuese mbetet problematika e ngritur më herët nga Gjokë Faslia në fshatin Porav të Fierzës për ujin e pijshëm. Është ngritur një komision me vendim këshilli qysh në Korrik dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap për zgjidhjen e situatës. Familjet presin ne për ndërhyrje sepse çeshtja siç dihet ka shkuar edhe në Prokurori dhe ato familje janë të gatshme për marrëveshje në prezencën tonë.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Javën që vjen do jemi të gatshëm të organizojmë këtë takim.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 8 e rendit të ditës: Të ndryshme

Besjana Marku, anëtare e KB:

Është duke përfunduar java e tretë mësimore për këtë Vit të Ri shkollor dhe nuk është bërë asnjë lloj ndërhyrje sa i përket lyerjes, hidrogjenizimit në shkollat e Njësisë Administrative Blerim. Ka dy vjet që flitet për investime port të paktën të lyhen. Vjet janë lyer pjesërisht ndërsa sivjet nuk është vënë dorë fare për asgjë.

Ne nuk kemi detyrë si mësues të lyejmë shkollat vetë. Vërtet në atë shkollë mund të ketë një ose dy fëmijë por kushtet duhet t'ju krijohen njësoj si gjithë të tjerëve.

Gjithashtu rrugët e fshatrave janë tejet në domosdoshmëri për tu pastruar, ju lutem merrni masa për këtë. Thuhet që banorët kanë bërë kërkesa të tilla për pastrim rrugësh por nuk e dimë se pse nuk kanë ardhë këto kërkesa në këshill.

Në Dardhë nuk ka hy asnjë fadromë nga ana e bashkisë për pastrim rrugësh për dy vite me radhë. Ne e dimë që Njësitë Administrative nuk kanë fonde për këtë sepse fondet i ka tashmë Bashkia për këto shërbime.

Ju lutem ktheni vëmendjen edhe në fshatrat e bashkisë jo vetëm në Qendër. Në ditën e parë të fillimit të Vitit të Ri shkollor kishte prezencë të përfaqësuesve të bashkisë vetëm në shkollat e Qendrës së qytetit, ndërsa në fshatra jo.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë:

Për Blerimin ka të drejtë këshilltarja sa i përket rrugëve. Kemi konfirmuar me Emergjencat civile që shumë shpejt do të vijë një mjet për pastrimin e rrugëve dhe një tjetër është ai i konfirmuar nga Ambasada Japoneze, vonesa është vetën se duhet një afat kohor për të mbërritur në Shqipëri, vjen nga jashtë shtetit.

Nuk do të ketë më asnjë rrugë të pa mirëmbajtur në çdo skaj të Fushë-Arrëzit nga momenti që do mbërrijnë këtu mjetet e pastrimit, dy fadromat.

Ne kemi lyer shkolla edhe pa patur asnjë nxënës brenda. Një punonjës, Bilali është ngarkuar për lyerjen e shkollave. Sa i përket infrastrukturës së shkollave, ju e dini situatën se si ka qenë dhe ne po përpiqemi edhe përmes donatorëve të bëjmë më të mirën e mundshme. Në Iballë kemi lyer ambjentet ku bëhet mësim.

Ju garantoj që çdo qindarkë e përlogaritur do të shkojë në destinacionin e përcaktuar.

Besjana Marku, anëtare e KB:

Të gjithë e dimë se çfarë kotastrofe është bërë në pyjet e Xathit. Mendoj fortësisht se kjo situatë ka ardhë si pasojë e neglizhencës së punonjësve të Pyjores. Unë ju bëj thirrje Kryetarit të bashkisë dhe të gjithë punonjësve përgjegjës që marrin rrogën nga shteti të rrisin kërkesën e llogarisë për punën dhe të mos kemi situata të tilla të zjarreve më.

E përsëris që jam e bindur që zjarret kanë rënë vetëm për neglizhencë të vigjilencës së punonjësve të Pyjores, sepse në ditën që ka rënë zjarri një punonjës ka qenë në Tiranë nuk ka qenë në vendngjarje. Ju lutem merrni masa duke shtrënguar kërkesën e llogarisë punonjësve të Pyjores.

Angazhimi i Njesisë Administrative dhe i MKZ-së ka qenë maksimal, por punëtori që merr rrogën për atë zonë në ditën e rënies së zjarrit nuk ka qenë.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë:

Unë mendoj se perceptimi yt është i drejtë lidhur me gatishmërinë e mbrojtjes së pyjeve nga zjarri, por zjarret kanë rënë në prona private, rastet janë në hetim.

Shqetësues është fakti që zjarri ka rënë dy herë në të njëjtin vend dhe pikërisht në tokat private prandaj përgjegjësit janë privat, kjo nuk e zvogëlon përgjegjësinë e punonjësve të pyjores. Edhe përtej detyrës shtetërore ne kemi bërë gjithçka që kemi pasë mundësi për zvogëlimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri.

Ju siguroj që do të merren masa ndaj çdonjërit që do të identifikohen si abuzues dhe në shkelje të rregullit dhe ligjit. Ne jemi në bashkëpunim e policinë për rendin dhe sigurinë. Shefi i rendit në Fushë-Arrëz është tejet i angazhuar për çdo problematikë të tillë, duke e ndjekur situatën vetë në terren.

Lin Prendi, anëtar i KB:

Unë nuk e di ekzaktësisht se kush është përgjegjës për ruajtjen e pyjeve në atë zonë, por kur faktet tregojnë rrënim të asaj pasurie për prerje , zjarre apo çfarëdo tjetër duhet të merren masa kushdo qoftë ai.

Bardhok Qafa, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtua.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

Franc Doda

[Signature]

ZV/ KRYETAR

Bardhok QAFA

[Signature]

Valentina Lleshaj
[Signature]

